



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE
KËSHILLI DREJTUES

Nr. Prot. _____

Tiranë ___/___/2026

VENDIM

Nr. 14, datë 30.04.2026

PËR
MIRATIMIN E “RAPORTIT PËR VEPRIMTARINË VJETORE TË INVESTIMIT
TË “FONDIT TË NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME” GJATË VITIT
2025”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, pika 1, shkronja m/1 të ligjit nr. 53/2024 “Për sigurimin e depozitave” të ndryshuar, të nenit 71 pika 2, të nenit 73, pikat 1, 2 dhe 3, dhe të nenit 79, pika 5 të ligjit nr. 133/2016, datë 22.12.2016 “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 18, pika 1 të Rregullores “Për Fondin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe procedurat për administrimin e tij”, të miratuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 56, datë 3.10.2017, të ndryshuar, të nenit 6, pika 2, shkronja “g”, të nenit 9, pika 3 të Statutit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, të miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues nr 24, datë 31.10.2018, të nenit 6/1, shkronja “e” të Rregullores nr. 20, datë 25.09.2017 “Për nënshkrimet e autorizuara në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave”, të ndryshuar, të vendimit të Këshillit Drejtues nr. 31, datë 10.10.2025 “Për caktimin e Z. Martin Blushi, Zëvendës drejtor i Përgjithshëm, për të ushtruar kompetencat për mbarëvajtjen e veprimtarisë së përditshme të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, deri në emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm”, të nenit 18, pika 2 të Rregullores “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, të miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014, si dhe me propozim të Zëvendës drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues,

V E N D O S I:

1. Miratimin e “Raportit për veprimtarinë vjetore të investimit të “Fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme” gjatë vitit 2025, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Zëvendës drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë për dërgimin e raportit, sipas pikës 1 të këtij vendimi, në Bankën e Shqipërisë.





3. Ngarkohet Sektori i Analizës së Riskut, si dhe Sektori i Financës dhe Investimeve, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Donald Duraj

Kryetar

Tianda Kaçi

Sekretare

